

**Republika e Kosovës**  
*Republika Kosova – Republic of Kosovo*

**Komuna e Mitrovicës Veriore**  
*Opština Severna Mitrovica – Municipality of North Mitrovica*

# **KORNIZA AFATMESME BUXHETORE 2026 – 2028**

**Me përmirësime pas Seances së Kuvendit Komunal**

**Qershor, 2025**

## **PËRMBAJTJA:**

|                                                                                                   |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2026 – 2028.....                                             | 3  |
| MISIONI:.....                                                                                     | 4  |
| Objektivat Strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës.....                                  | 6  |
| OBJEKTIVAT DHE PËRFITIMET E PROCESIT TË KORNIZËS AFATMESE TË SHPENZIMEVE (KASH) PËR KOMUNAT ..... | 7  |
| Objektivat kryesore të procesit KASH për komunat: .....                                           | 7  |
| Efikasiteti dhe efektiviteti:.....                                                                | 7  |
| Kontrolli dhe menaxhimi: .....                                                                    | 8  |
| Kapacitetet njerëzore dhe teknologjia:.....                                                       | 8  |
| Sigurimi i disiplinës financiare: .....                                                           | 8  |
| Ekonomia dhe zhvillimi lokal:.....                                                                | 8  |
| Sistemet operative dhe transparencë:.....                                                         | 8  |
| Veprime të lidhura me objektivat: .....                                                           | 9  |
| Perspektiva e politikave fiskale: .....                                                           | 9  |
| PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE 2026-2028 .....                                         | 10 |
| VLERËSIMET E HERËSHME TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE BUXHETORE                                      |    |
| Tabela 3.....                                                                                     | 14 |
| GRANTET QEVERTARE DHE TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE 2026 – 2028–                                     |    |
| TABELA 4.....                                                                                     | 15 |
| ZYRA E KRYETARIT.....                                                                             | 16 |
| ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL .....                                                                     | 17 |
| DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME.....                                                    | 18 |
| DREJTORIA PËR FINANCA , BUXHET DHE ZHVILLIM EKONOMIK .....                                        | 19 |
| DREJTORIA PËR SHËRBIMEVE PUBLIKE , INFRASTRUKTURË DHE INSPEKSION. ....                            | 20 |
| DREJTORIA PËR SIGURI DHE EMERGJENCA .....                                                         | 21 |
| NJËSIA E ZJARRFIKËSVE .....                                                                       | 22 |
| DREJTORIA PËR URBANIZËM , KADASTËR DHE GJEODEZI .....                                             | 23 |
| DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT .....                                                       | 24 |
| DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE .....                                              | 25 |
| ZYRA PËR KOMUNITETE LOKALE DHE KTHIM.....                                                         | 26 |
| DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE MBROJTJES SË MJEDISIT DHE PYJEVE .....                  | 27 |

## **Lista e Tabelave:**

|                                                                                                                                                                                                                                           |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>Tabela 1.</b> PJEËMARRJA E GRANTEVE NË TOTALIN E BUXHETIT KOMUNAL SIPAS VITEVE 2026 – 2028.....                                                                                                                                        | 9  |
| <b>Tabela 2.</b> PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE 2026 – 2028.....                                                                                                                                                               | 12 |
| <b>Tabela 3.</b> Ndarja së shpenzimeve të përgjithshme sipas kategorive ekonomike për periudhën 2026–2028.....                                                                                                                            | 14 |
| <b>Tabela 4.</b> Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik i Arsimit, Granti Specifik për Shëndetësi, Financimet për Shëndetësi Sekondare , Shërbimet Rezidenciale si dhe plani i të Hyrave Vetanake Komunale sipas viteve 2026 – 2028 ..... | 15 |

## **Lista e Figurave:**

|                                                                                                                                                                                                                                           |    |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| <b>Figura 1.</b> PJEËMARRJA E GRANTEVE NË FINANCIMIN E BUXHETIT KOMUNAL 2026 SIPAS QARKORES BUXHETORE 2026/01 .....                                                                                                                       | 10 |
| <b>Figura 2.</b> PARAQITJA GRAFIKE E TË HYRAVE VETANAKE NË KAB- KOMUNAL SIPAS VITEVE 2026 – 2028 .....                                                                                                                                    | 13 |
| <b>Figura 3.</b> Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik i Arsimit, Granti Specifik për Shëndetësi, Financimet për Shëndetësi Sekondare , Shërbimet Rezidenciale si dhe plani i të Hyrave Vetanake Komunale sipas viteve 2026 – 2028 ..... | 15 |

## **KORNIZA AFATMESME BUXHETORE KOMUNALE 2026 – 2028**

**Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2026–2028 e Mitrovicës Veriore** është dokumenti bazik strategjik i nivelit të lartë, i cili pasqyron caqet e përgjithshme të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore si dhe strukturën përkatëse sipas kategorive ekonomike. Qëllimi i këtij dokumenti është përmbushja e objektivave të përcaktuara në Strategjinë Zhvillimore Afatmesme të Komunës. Si pjesë integrale e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) të Kosovës, kjo kornizë është hartuar në përputhje me procedurat buxhetore 2026–2028, të përcaktuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) përmes Qarkores Buxhetore 2026/01 për Komunat, të lëshuar më 15.05.2025.

KAB promovon rritjen e mirëqenies sociale përmes zgjerimit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike, në veçanti atyre sociale dhe familjare, duke pasur në fokus grupet në nevojë dhe avancimin e barazisë gjinore. Në këtë drejtim, planifikimi i buxhetit për periudhën 2026–2028 është realizuar me një qasje të ndjeshme gjinore, duke analizuar dhe përfshirë nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale përbën një mjet të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të buxhetit, pasi ndërlihd burimet e disponueshme me prioritetet strategjike të komunës në një mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar. Çdo program dhe nënprogram buxhetor është trajtuar me kujdes, për të siguruar që objektivat të jenë të qarta dhe të arritshme, me komponentë të ndjeshëm gjinor dhe me fokus në përmirësimin e shërbimeve për të gjithë qytetarët.

Përmes kësaj Kornize do të paraqiten politikat dhe prioritetet aktuale dhe afatmesme të Komunës së Mitrovicës Veriore, si dhe projeksionet për mënyrën e realizimit dhe mbështetjes buxhetore të projekteve prioritare për periudhën 2026–2028, duke u bazuar në dokumentet ligjore në fuqi, përfshirë:

- Ligjin për Financat e Pushtetit Lokal,
- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë,
- Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale,
- Ligjin për Kufijtë Administrativë Komunal,
- Ligjin vjetor për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Planifikimi i buxhetit për vitet 2026–2028 është zhvilluar mbi bazën e metodës së buxhetimit sipas programeve, duke u mbështetur në objektivat dhe deklaratat e misioneve të secilit program. Qarkorja Buxhetore 2026/01 ofron kontekstin dhe sfondin për këtë proces, duke përcaktuar qartë prioritetet programore dhe kërkesat për efikasitet dhe kursim në përdorimin e fondeve publike.

Gjatë çdo faze të hartimit të KAB 2026–2028, janë marrë parasysh kërkesat dhe sugjerimet e qytetarëve dhe grupeve të interesit. Përfshirja e drejtpërdrejtë e nevojave të burrave dhe grave synon të rrisë transparencën, efikasitetin dhe barazinë në shpërndarjen e burimeve publike, për të përmirësuar mirëqenien e përgjithshme të komunitetit.

## **MISIONI:**

Të përmirësojmë mirëqenien e qytetarëve përmes ofrimit të shërbimeve efikase, cilësore dhe gjithëpërfshirëse, duke u fokusuar në zgjidhjen e problemeve të përditshme të grave dhe burrave, në mënyrë të barabartë dhe me përgjegjësi institucionale.

Komuna e Mitrovicës Veriore synon zhvillim të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe të drejtë për të gjithë qytetarët, përmes këtyre objektivave kryesore:

### **Zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe mjedisor**

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe ambientit, në qytet dhe fshatra, me ndriçim publik të sigurt dhe gjithëpërfshirës, duke garantuar qasje të barabartë për të gjitha grupet e qytetarëve, veçanërisht gratë dhe komunitetet në nevojë.

### **Planifikimi hapësinor dhe zhvillimi ekonomik**

- Hartimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) dhe i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal, në përputhje me prioritetet e komunitetit dhe parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Hartimi i planeve rregullative dhe hartave zonale për një planifikim të mirëfilltë të hapësirës urbane dhe rurale.

### **Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore**

- Zhvillimi i shërbimeve të shëndetit publik, përfshirë kujdesin primar, shëndetin riprodhues, kujdesin për shëndetin mendor dhe shërbimet paliative, duke përfshirë gjithashtu edukimin dhe promovimin shëndetësor.

### **Arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës**

- Rritja e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, si dhe ngritja e cilësisë së sistemit arsimor në të gjitha nivelet.

### **Zhvillimi i kulturës, sportit dhe rinisë**

- Mbështetja e aktiviteteve kulturore dhe sportive përmes infrastrukturës funksionale dhe subvencioneve për organizatat e shoqërisë civile, me barazi gjinore në përfitime (50% gra/vajza dhe 50% burra/djem).

### **Fuqizimi ekonomik dhe mbështetja e të rinjve**

- Nxitja e ndërmarrësisë dhe vetëpunësimit përmes START-UP-ve, me përfshirje të balancuar gjinore (60% gra/vajza dhe 40% burra/djem), duke kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe barazinë sociale.

### **Qeverisje digjitale dhe gjithëpërfshirëse**

- Lehtësimi i qasjes në shërbime administrative përmes digjitalizimit (e-kiosqeve dhe platformave online), me fokus në transparencë, efikasitet dhe përfshirjen e të gjitha grupeve, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

## **Objektivat Strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës**

Në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe prioritetet zhvillimore të vendit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

### **1. Qeverisje e mirë dhe transparente**

- ❖ Fuqizimi i institucioneve publike për të siguruar qeverisje të përgjegjshme, transparente dhe në shërbim të qytetarëve.

### **2. Sundimi i ligjit dhe siguria publike**

- ❖ Forcimi i rendit dhe ligjit përmes institucioneve të drejtësisë dhe të sigurisë, me qëllim të garantimit të drejtësisë dhe sigurisë për të gjithë qytetarët.

### **3. Zhvillim ekonomik dhe modernizim i shtetit**

- ❖ Nxitja e rritjes ekonomike përmes reformave strukturore, përmirësimit të klimës së të bërit biznes dhe investimeve në infrastrukturë dhe inovacion.

### **4. Arsimit cilësor dhe konkurrues**

- ❖ Përmirësimi i cilësisë në të gjitha nivelet arsimore dhe përafrimi i aftësive të nxënësve me kërkesat e tregut të punës, në përputhje me standardet evropiane.

### **5. Shëndetësi funksionale dhe efikase**

- ❖ Rritja e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për të gjithë qytetarët, me fokus në kujdesin primar, parandalimin dhe digjitalizimin e sistemit shëndetësor.

### **6. Integrimi ndërkombëtar dhe siguria kolektive**

- ❖ Avancimi i procesit të integritimeve Euro-Atlantike, duke synuar anëtarësimin në organizata ndërkombëtare si OKB dhe NATO.

### **7. Forcimi i kapaciteteve të mbrojtjes**

- ❖ Modernizimi dhe zhvillimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës në përputhje me standardet e NATO-s, si një komponentë e rëndësishme e sigurisë kombëtare.

## OBJEKTIVAT DHE PËRFITIMET E PROCESIT TË KORNIZËS AFATMESE TË SHPENZIMEVE (KASH) PËR KOMUNAT

Procesi i KASH-it është një mjet i rëndësishëm për planifikim buxhetor afatmesëm, i cili fuqizon komunat përmes një qasjeje më të koordinuar, transparente dhe gjithëpërfshirëse. Inkorporimi i tij synon:

### Objektivat kryesore të procesit KASH për komunat:

- 🚧 Të ofrojë një kornizë gjithëpërfshirëse dhe realiste për planifikimin dhe realizimin e shpenzimeve buxhetore për periudhën trevjeçare;
- 🚧 Të sigurojë parashikueshmëri dhe qëndrueshmëri buxhetore, përmes një vlerësimi më të besueshëm të të hyrave vetanake dhe shpenzimeve;
- 🚧 Të përmirësojë lidhjen ndërmjet burimeve financiare dhe prioriteteve të politikave komunale;
- 🚧 Të fuqizojë drejtoritë komunale në shpërndarjen, menaxhimin dhe shfrytëzimin efikas të burimeve;
- 🚧 Të mundësojë planifikim objektiv dhe të bazuar në kategori ekonomike përmes sistemit BDMS;
- 🚧 Të mundësojë hartimin e Planit të rrjedhës së parasë së gatshme (Cash Flow);
- 🚧 Të mundësojë planifikimin e investimeve kapitale përmes sistemit PIP (Programi i Investimeve Publike);
- 🚧 Të sigurojë zbatim të buxhetimit gjinor në të gjitha fushat, si garantues i barazisë dhe gjithëpërfshirjes sociale;

### Efikasiteti dhe efektiviteti:

- ✓ Shpenzim i buxhetit në mënyrë të përgjegjshme dhe të orientuar në rezultat;
- ✓ Planifikimi sipas kodeve/nënkodeve ekonomike;
- ✓ Respektimi i afateve për realizimin e projekteve;
- ✓ Shmangia e shpenzimeve të panevojshme dhe rritje e shfrytëzimit të burimeve ekzistuese;
- ✓ Përdorimi efikas i kontratave kornizë dhe përzgjedhje e projekteve me prioritet;
- ✓ Pagesa në kohë dhe shmangia e pagesave direkte nga Thesari.

**Kontrolli dhe menaxhimi:**

- Zbatim i rekomandimeve të auditorëve të ZKA;
- Inventarizimi dhe menaxhimi i pasurisë komunale;
- Menaxhimi efektiv i bazës së të dhënave dhe i të hyrave vetanake;
- Rritje e performancës në inkasim dhe funksionalizim i Zyrës së Tatimit në Pronë;
- Futja e tarifave të reja të justifikuara dhe përditësimi i tarifave ekzistuese.

**Kapacitetet njerëzore dhe teknologjia:**

- Trajnime për stafin komunal në menaxhim financiar dhe përdorim të softuerëve të avancuar;
- Profesionalizim i shërbimeve për të përmirësuar cilësinë e vendimmarrjes dhe transparencën.

**Sigurimi i disiplinës financiare:**

- Harmonizimi me legjislacionin përkatës financiar;
- Rekrutimi dhe funksionalizimi i Auditorit të Brendshëm;
- Informim dhe transparencë publike për vendimet buxhetore;
- Planifikim dhe ekzekutim në përputhje me planin e rrjedhës së parasë dhe programin PIP;
- Respektimi i Ligjit të Buxhetit dhe ndalimi i hyrjes në obligime pa zotime të mbuluara.

**Ekonomia dhe zhvillimi lokal:**

- Hartimi i Strategjisë Komunale të Zhvillimit Ekonomik;
- Krijimi i kushteve për investime dhe për donatorë të brendshëm dhe të jashtëm;
- Hartimi i Strategjisë së Turizmit dhe Biodiversitetit si pjesë e zhvillimit të qëndrueshëm.

**Sistemet operative dhe transparenca:**

- Përmirësimi i procedurave të prokurimit dhe kontabilitetit;
- Koordinim ndërdrejtorish dhe evidencë e duhur financiare;
- Rritja e transparencës përmes informimit publik dhe pjesëmarrjes qytetare.

**Veprime të lidhura me objektivat:**

- Parandalimi dhe legalizimi i ndërtimeve pa leje;
- Hartimi i planit të punës dhe buxhetit për vitin 2025;
- Mbajtja e dëgjimeve publike buxhetore;
- Menaxhimi, vlerësimi dhe monitorimi i projekteve dhe bazës së të dhënave;
- Përmirësimi i përgjegjshmërisë komunale në të gjitha fushat e kompetencës.


**Perspektiva e politikave fiskale:**

- Fokus i veçantë në balancimin gjinor në planifikimin e të hyrave dhe shpenzimeve;
- Mbështetje për nevojat gjinore në punësim, pjesëmarrje në vendimmarrje, kulturë, subvencione e më tej;
- Masat për mbledhje më efektive të të hyrave komunale dhe rritja e vetëdijes qytetare për obligimet fiskale.

*Tabela 1. PJESEMARRIA E GRANTEVE NË TOTALIN E BUXHETIT KOMUNAL SIPAS VITEVE 2026 – 2028*

| Nr | Fondi Burimor                         | Planifikimi 2026    | Parashikimi 2027    | Parashikimi 2028    |
|----|---------------------------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| 1  | Granti i Përgjithshëm                 | 3,289,654.00        | 3,196,999.00        | 3,444,618.00        |
| 2  | Granti i Arsimit                      | 1,819,401.00        | 1,873,983.00        | 1,930,202.00        |
| 4  | Granti i Shëndetësisë                 | 480,594.00          | 495,012.00          | 509,862.00          |
| 5  | Financimi për Shëndetësi<br>Sekondare | 989,935.00          | 989,935.00          | 989,935.00          |
| 6  | Shërbime Rezidenciale                 | -                   | -                   | 250,000.00          |
| 7  | Të Hyrat Vetanake                     | 135,700.00          | 142,700.00          | 143,200.00          |
|    |                                       | <b>6,715,284.00</b> | <b>6,698,629.00</b> | <b>7,267,817.00</b> |

Figura 1. PJEËMARRJA E GRANTEVE NË FINANCIMIN E BUXHETIT KOMUNAL 2026  
SIPAS QARKORES BUXHETORE 2026/01



## PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE 2026-2028

Të hyrat komunale të komunës së Mitrovicës Veriore realizohen në bazë të Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Rregullorës mbi Tarifat dhe Gjoha Komunale, si dhe dispozitave tjera ligjore që përcaktojnë llojet e ndryshme të të hyrave të cilat komuna ka të drejtë t'i caktojë dhe t'i inkasojë.

Deri në fund të vitit 2024, mungesa e Zyrës së Tatimit në Pronë dhe Tokë ka ndikuar që baza e të hyrave të fokusohej kryesisht në të hyrat nga regjistrimi i automjeteve dhe taksat e tjera komunale. Megjithatë, në vitin fiskal 2025, kjo zyrë është funksionalizuar dhe ka filluar të inkasoj të hyra nga tatimi në pronë, duke kontribuar ndjeshëm në rritjen e bazës së të hyrave vetanake. Po ashtu, pritet të rriten edhe shërbimet e ndryshme komunale, si dhe të zgjerohet më tej gama e të hyrave vetanake përmes aplikimit të tarifave të reja dhe zgjerimit të mbulueshmërisë së inkasimit.


**Kategoritë kryesore të të hyrave vetanake për periudhën 2026–2028 përfshijnë:**

- **Tatimi në pronë dhe tokë** – burimi primar i të hyrave pas funksionalizimit të Zyrës për Tatimin në Pronë;
- **Taksat për shërbime komunale** – përfshirë taksat për shërbime të ndryshme, taksat administrative dhe ato për lejet ndërtimore;
- **Taksat për veprimtari afariste** – përfshijnë pagesat për licenca, ushtrimin e veprimtarive afariste dhe shërbimet profesionale;
- **Taksat për automjete** – regjistrimi dhe licencimi i automjeteve motorike;
- **Të hyrat nga dokumentet zyrtare** – përfshirë certifikatat dhe dokumentacionin tjetër të lëshuar nga komuna;
- **Qirat komunale** – nga pronat komunale, si objektet dhe toka;
- **Participimi i qytetarëve në shërbime publike** – në arsim dhe shëndetësi;
- **Të hyrat tjera** – përfshijnë tarifa të reja të aprovuara, pagesa të ndryshme për shërbime komunale, si dhe të ardhura që rrjedhin nga rritja e mbulueshmërisë së inkasimit dhe aktivitetet e reja komunale.

*Tabela 2. PLANIFIKIMI I TË HYRAVE VETANAKE KOMUNALE 2026 – 2028*

| KOMUNA E MITROVICË VERIORE |                                                    | Planifikimi<br>2026 | Planifikimi<br>2027 | Planifikimi<br>2028 |
|----------------------------|----------------------------------------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| 50013                      | Taksa për Çertifikatë të Lindjes                   | 11,500.00           | 11,500.00           | 11,500.00           |
| 50015                      | Taksa për Çertifikatë të Vdekjes                   | 1,000.00            | 1,000.00            | 1,000.00            |
| 50014                      | Taksa për Çertifikatë të Kurorëzimit               | 2,500.00            | 2,500.00            | 2,500.00            |
| 50016                      | Taksa për Çertifikata tjera të Gjendjes Civile     | 12,000.00           | 12,000.00           | 12,000.00           |
| 50017                      | Taksa për Verifikim të Dokumenteve të Ndryshme     | 4,000.00            | 4,000.00            | 4,000.00            |
| 50107                      | Gjjobat të tjera                                   | 2,500.00            | 3,500.00            | 2,500.00            |
| 50001                      | Taksa për Regjistrim të Automjeteve                | 22,000.00           | 22,500.00           | 22,000.00           |
| 50009                      | Taksa Komunale për Leje Ndërtimi                   | 12,000.00           | 14,000.00           | 15,000.00           |
| 50019                      | Tarifa të tjera administrative-Urb                 | 1,500.00            | 1,500.00            | 1,500.00            |
| 50012                      | Taksa për Ndërrim të Destinimi të Tokës            | 10,000.00           | 10,000.00           | 10,000.00           |
| 50011                      | Taksa për Ndërrim të Pronarit të Pronës            | 3,500.00            | 3,500.00            | 3,500.00            |
| 50504                      | Taksa për Matjen e Pronës së Paluajtshme           | 4,800.00            | 5,800.00            | 6,300.00            |
| 50019                      | Regjistrimi dhe fshirja e hipotekës                | 1,000.00            | 1,000.00            | 1,000.00            |
| 50104                      | Dënimet e inspektorëve                             | 1,000.00            | 1,000.00            | 1,000.00            |
| 50019                      | Tarifa të tjera administrative -insp               | 1,000.00            | 1,000.00            | 1,000.00            |
| 50032                      | Taksa për çertifikatë të Pronësisë dhe Kopje Plani | 9,700.00            | 8,700.00            | 8,700.00            |
| 40110                      | Tatimi në prone                                    | 4,500.00            | 4,800.00            | 5,000.00            |
| 40110                      | Tatimi në toke                                     | 1,200.00            | 1,400.00            | 1,700.00            |
| 50405                      | Qiradhënia e Pronës Publike                        | 30,000.00           | 33,000.00           | 33,000.00           |
| GJITHSEJT TË HYRAT         |                                                    | 135,700.00          | 142,700.00          | 143,200.00          |

*Figura 2. PARAQITJA GRAFIKE E TË HYRAVE VETANAKE NË KAB- KOMUNAL SIPAS VITEVE 2026 – 2028*



## VLERËSIMET E HERËSHME TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMEVE BUXHETORE

Vlerësimet e hershme të shpenzimeve përfshijnë kornizat fillestare për secilin program buxhetor, të ndërtuara mbi bazën e të hyrave të planifikuara dhe të modifikuara vetëm në përputhje me indikatorët makroekonomikë dhe fiskalë. Këto vlerësime mbështeten në buxhetin e miratuar për vitin 2025 si dhe në trendët e shpenzimeve të realizuara gjatë viteve të fundit.

Kjo kornizë përfaqëson një projeksion trevjeçar të shpenzimeve të përgjithshme komunale për periudhën 2026–2028. Të hyrat vetanake paraqiten me një trend rritës, ashtu si edhe grantet nga niveli qendror, të cilat do të integrohen më tej në përlllogaritjet zyrtare përmes Qarkoreve Buxhetore dhe kufijve të caktuar buxhetorë që do të përcaktohen në fazat e ardhshme të procesit buxhetor.

Më poshtë paraqitet një përmbledhje e ndarjes së shpenzimeve të përgjithshme sipas kategorive ekonomike për periudhën 2026–2028.

*Tabela 3. Ndarja së shpenzimeve të përgjithshme sipas kategorive ekonomike për periudhën  
2026–2028.*

| NR. | KATEGORITË<br>EKONOMIKE      | 2026                | 2027                | 2028                |
|-----|------------------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| 1   | PAGA DHE SHTESA              | 3,373,656.00        | 3,566,356.00        | 3,853,011.00        |
| 2   | MALLËRA DHE SHËRBIME         | 680,000.00          | 620,000.00          | 680,000.00          |
| 3   | SHPENZIME KOMUNALE           | 130,000.00          | 130,000.00          | 170,000.00          |
| 4   | SUBVENCIONE DHE<br>TRANSFERE | 200,000.00          | 200,000.00          | 250,000.00          |
| 5   | INVESTIME KAPITALE           | 2,331,628.00        | 2,182,273.00        | 2,314,806.00        |
|     | <b>TOTALI</b>                | <b>6,715,284.00</b> | <b>6,698,629.00</b> | <b>7,267,817.00</b> |
|     | <b>STAFI</b>                 | <b>830</b>          | <b>830</b>          | <b>830</b>          |

*Sqarim: Numri i stafit të OB 647 nuk është final, pasi që këto të dhëna do të finalizohen me qarkoren buxhetore 2026/02*


## GRANTET QE VERITARE DHE TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE

### 2026 – 2028

*Tabela 4. Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik i Arsimit, Granti Specifik për Shëndetësi, Financimet për Shëndetësi Sekondare , Shërbimet Rezidenciale si dhe plani i të Hyrave Vetanake Komunale sipas viteve 2026 – 2028*

| Viti | Granti i Përgjithshëm | Granti specifik për Arsimit | Granti specifik për Shëndetësi Primare | Financimet për Shëndetësi Sekondare | Shërbime Rezidenciale | Gjithsej Granti | TË HYRAT VETANAKE | TOTALI       |
|------|-----------------------|-----------------------------|----------------------------------------|-------------------------------------|-----------------------|-----------------|-------------------|--------------|
| 2026 | 3,289,654.00          | 1,819,401.00                | 480,594.00                             | 989,935.00                          | -                     | 6,579,584.00    | 135,700.00        | 6,715,284.00 |
| 2027 | 3,196,999.00          | 1,873,983.00                | 495,012.00                             | 989,935.00                          | -                     | 6,555,929.00    | 142,700.00        | 6,698,629.00 |
| 2028 | 3,444,618.00          | 1,930,202.00                | 509,862.00                             | 989,935.00                          | 250,000.00            | 7,124,617.00    | 143,200.00        | 7,267,817.00 |

*Figura 3. Granti i Përgjithshëm, Granti Specifik i Arsimit, Granti Specifik për Shëndetësi, Financimet për Shëndetësi Sekondare , Shërbimet Rezidenciale si dhe plani i të Hyrave Vetanake Komunale sipas viteve 2026 – 2028*



## **ZYRA E KRYETARIT**

**Kryetar: z. Erden ATIQ**

**Nënkryetare: znj. Katarina ADJANCIC**

### **Deklarata e misionit:**

Misioni im si kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore është të udhëheq me përgjegjësi dhe transparencë për të ndërtuar një komunitet të fortë dhe të bashkuar, ku çdo qytetar ka qasje të barabartë në shërbime publike cilësore dhe mundësi për zhvillim personal dhe ekonomik. Ne angazhohemi për të përmirësuar infrastrukturën, për të promovuar arsimin dhe shëndetësinë, dhe për të nxitur një mjedis të favorshëm për bizneset dhe investimet. Me një qeverisje të drejtë dhe të hapur, synojmë të krijojmë një të ardhme më të mirë dhe më të ndritshme për të gjithë qytetarët tanë, duke respektuar dhe mbrojtur trashëgiminë tonë kulturore dhe mjedisore.

### **Deklarata e vizionit:**

Vizioni im është që Komuna e Mitrovicës Veriore të jetë një model i zhvillimit të qëndrueshëm dhe të integruar, ku çdo qytetar ndjen siguri dhe mirëqenie. Synoj të krijoj një komunitet të bashkuar dhe të përparuar, me infrastrukturë moderne, arsim cilësor, shërbime shëndetësore të përparuara dhe mundësi të barabarta për zhvillim ekonomik. Duke promovuar transparencën, përgjegjshmërinë dhe pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, ne do të punojmë së bashku për të ndërtuar një të ardhme më të ndritshme dhe më të begatë për brezat e ardhshëm. Me respekt për trashëgiminë tonë kulturore dhe mjedisin, do të krijojmë një ambient të favorshëm për jetë dhe punë, duke bërë Mitrovicën Veriore një vend të dëshiruar për të jetuar dhe investuar.

## **ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL**

**Kryesues i Kuvendit Komunal: z. Nedzad UGLJANIN**

### **Deklarata e misionit:**

Duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, ligjet në fuqi, Statutin e Komunës, Rregulloret, udhëzimet e Kuvendit të Komunës, zyra e kuvendit duhet: Të ofroj zbatimin e tyre në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase. Organizon punën e Kuvendit të Komunës, duke planifikuar buxhetin kujdeset për menaxhimin optimal të tij.

Kryen punët administrative dhe profesionale duke përfshirë këtu edhe punët teknike për organizimin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, komiteteve dhe komisioneve punuese të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu edhe përpilimin e projekt-akteve që i procedohen për miratim këtyre organeve.

Punë të tjera për të gjitha organet e administratës duke përfshirë këtu pranimin e shkresave të ndryshme, dorëzimin dhe ekspeditivin e shkresave zyrtare, vërtetimin e dokumenteve dhe nënshkrimin, punët e arkivit dhe ekspeditivit.

### **Deklarata e vizionit:**

Duke menaxhuar me buxhetin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës konform vendimit të Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit dhe duke u bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi, duke përfshirë këtu edhe vendimet e Kuvendit të Komunës, angazhohet që qytetarëve të Komunës t'u ofrohen shërbime sa më të mira dhe më të shpejta konform detyrave dhe përgjegjësiive të Kuvendit të Komunës, duke përfshirë këtu lëshimin e dëshmimeve për Anëtarët e Kuvendit të Komunës, përpilon vendimet e Kuvendit bën ekspeditivin e akteve zyrtare e materiale për nevojat e Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të tij, bënë përpunimin administrativ-teknik të akteve dhe lëndëve, arkivimin e lëndëve.

## **DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME**

**Drejtores: znj. Erita SUMA**

### **Deklarata e misionit:**

Misioni i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është të sigurojë një funksionim të qëndrueshëm, efikas dhe të koordinuar të administratës komunale, duke ofruar mbështetje profesionale, organizative dhe teknike për të gjitha strukturat komunale. Drejtoria synon të garantojë zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullave të mirëqeverisjes, të menaxhojë në mënyrë efektive burimet njerëzore dhe kapacitetet administrative, si dhe të krijojë kushte të favorshme për një administratë moderne, transparente dhe të orientuar drejt qytetarit. Përmes zhvillimit të vazhdueshëm të procedurave, përdorimit të teknologjisë dhe përmirësimit të shërbimeve të brendshme, kjo drejtori kontribuon në forcimin e institucioneve lokale dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike.

### **Deklarata e Vizionit:**

Vizioni i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme është të ndërtojë një administratë moderne, efikase dhe inovative, e cila vepron me integritet, profesionalizëm dhe përkushtim ndaj interesit publik. Drejtoria synon të jetë shtyllë mbështetëse për funksionimin e përgjithshëm të komunës, duke ofruar shërbime të brendshme cilësore, të digjitalizuara dhe të përshtatura me nevojat e kohës. Nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të proceseve administrative, zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe përdorimit të teknologjisë bashkëkohore, drejtoria aspiron të krijojë një administratë komunale të besueshme, transparente dhe të orientuar plotësisht drejt qytetarit dhe standardeve evropiane të qeverisjes lokale

## **DREJTORIA PËR FINANCA , BUXHET DHE ZHVILLIM EKONOMIK**

**Drejtore: znj. Mevlyde PECI-SHALA**

### **Deklarata e misionit:**

Misioni ynë është të sigurojmë menaxhim efikas, të përgjegjshëm dhe transparent të financave publike, të hartojmë dhe zbatojmë plane buxhetore që përmbushin nevojat e komunitetit, të nxisim zhvillimin ekonomik lokal përmes mbështetjes së biznesit dhe krijimit të mundësive të reja të punësimit, dhe të përmirësojmë cilësinë e shërbimeve publike për të gjithë qytetarët e komunës sonë. Ne angazhohemi për të ofruar transparencë dhe llogaridhënie në të gjitha proceset tona dhe për të siguruar një shpërndarje të drejtë dhe efektive të burimeve.

### **Deklarata e vizionit:**

Vizioni ynë është të krijojmë një komunë të prosperuar dhe të qëndrueshme ekonomikisht, ku burimet financiare menaxhohen me transparencë dhe efikasitet të lartë. Ne synojmë të jemi lider në inovacionin financiar dhe zhvillimin ekonomik lokal, duke krijuar një mjedis të favorshëm për investime dhe sipërmarrje, dhe duke përmirësuar vazhdimisht cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët tanë. Ne angazhohemi për zhvillim të qëndrueshëm që respekton mjedisin dhe për të ndërtuar një komunitet të fortë dhe të integruar ekonomikisht.

## **DREJTORIA PËR SHËRBIMEVE PUBLIKE , INFRASTRUKTURË DHE INSPEKSION**

**Drejtore: z. Fatir BERZATI**

### **Deklarata e misionit:**

Misioni ynë është të ofrojmë shërbime publike cilësore dhe të qëndrueshme, të mirëmbajmë dhe zhvillojmë infrastrukturën e komunës, të sigurojmë zbatimin e rregulloreve përmes inspektimeve efektive. Ne angazhohemi për të punuar me transparencë dhe përgjegjshmëri, duke përfshirë komunitetin në proceset tona dhe duke u siguruar që nevojat e qytetarëve të jenë gjithmonë prioriteti ynë. Përmes përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve dhe infrastrukturës, synojmë të krijojmë një mjedis të sigurt, të pastër dhe të organizuar, që mbështet zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës në Mitrovicën Veriore.

### **Deklarata e Vizionit:**

Vizioni ynë është të ndërtojmë një Komunë të Mitrovicës Veriore që ofron shërbime publike të klasit të parë, infrastrukturë moderne dhe të qëndrueshme, dhe një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur për të gjithë qytetarët. Ne synojmë të jemi një model i ekselencës në ofrimin e shërbimeve publike dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, duke siguruar që çdo qytetar të ketë akses në shërbime cilësore dhe të besueshme. Duke përdorur teknologjinë më të fundit dhe praktikën më të mirë, ne angazhohemi të mbikëqyrim dhe zbatojmë rregulloret në mënyrë efektive dhe transparente. Ne punojmë për të krijuar një të ardhme më të ndritshme dhe të qëndrueshme për Mitrovicën Veriore, ku qytetarët mund të jetojnë, punojnë dhe zhvillohen në një mjedis të sigurt dhe të mirëmbajtur.

## **DREJTORIA PËR SIGURI DHE EMERGJENCA**

**Drejt看: z. Tahir MIKULLOVCI**

### **Deklarata e misionit:**

Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca angazhohet të siguroj mbrojtje efektive të jetës,pronës dhe mjedisit përmes planifikimit,zhvillimit dhe zbatimit të projekteve kapitale të qëndrueshme. Ne synojmë ngritjen e kapaciteteve institucionale për parandalim,gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje në rast të emergjencave dhe katastrofave natyrore, teknologjike apo të tjera të shkaktuara nga natyra apo njeriu.

Misioni ynë është të sigurojmë mbështetje përmes investimeve në infrastrukturë, paisje dhe trajnime të stafit, në mënyrë që të garantojmë përfshirjen e projekteve kapitale në Kornizën Afatmesme të Buxhetit për periudhën 2026-2028, në përputhje me prioritetet komunale të sigurisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

### **Deklarata e Vizionit:**

Vizioni ynë është që të ndërtojmë një Komunë të sigurt dhe të përgatitur ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, menaxhimin e fatkeqësive dhe emergjencave, duke ndërtuar kapacitete të qëndrueshme duke investuar në teknologji moderne si dhe duke ngritur ndërgjegjësimin qytetar. E gjithë kjo bëhet duke u mbështetur në investime kapitale të planifikuara mirë dhe të harmonizuara me Kornizën Afatmesme të Buxhetit për 2026-2028.

## **NJËSIA E ZJARRFIKËSVE**

**Komandant i njësisë: z. Ranko RISTOVIC**

### **Deklarata e misionit:**

Mbrojtja e jetës së njerzve, të pasurisë, të shtazëve dhe mjedisit nga zjarri. Ndërmarrja e masave dhe veprimeve për evitimin e shkaqeve të zjarrit, për pengimin e mundësisë së zgjerimit të zjarrit, zbulimin dhe fikjen e zjarrit, për vërtetimin e shkaqeve të zjarrit si dhe dhënjën e ndihmës për largimin e pasojave të shkaktuara nga zjarri.

### **Deklarata e Vizionit:**

Mbrojtja dhe shpëtimi nga zjarri përmbanë: planifikimin organizimin, aftësimin, realizimin, mbikqyrjen, parandalimin nga zjarri, financimin e masave dhe aktiviteteve për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësitë tjera.

## **DREJTORIA PËR URBANIZËM , KADASTËR DHE GJEODEZI**

**Drejt看: z. Nuhi MEHMETI**

### **Deklarata e misionit:**

Misioni ynë është të sigurojmë planifikim urban të qëndrueshëm dhe të integruar, të menaxhojmë me efikasitet dhe transparencë pasuritë e paluajtshme, dhe të përdorim teknologjinë më të avancuar në gjeodezi për të mbështetur zhvillimin e komunës sonë. Ne angazhohemi për të ofruar shërbime cilësore dhe të sakta për qytetarët dhe bizneset, duke garantuar që të gjitha projektet e zhvillimit urban dhe menaxhimit të tokës janë të bazuara në të dhëna të sakta dhe të përditësuara. Përmes transparencës dhe përfshirjes së komunitetit në proceset tona, synojmë të krijojmë një mjedis urban të organizuar, të sigurt dhe të jetueshëm. Ne jemi të përkushtuar për të mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë kulturore dhe mjedisore, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm për të ardhmen e Mitrovicës Veriore.

### **Deklarata e Vizionit:**

Vizioni ynë është të që Komuna e Mitrovicës Veriore të jetë e zhvilluar dhe e organizuar në mënyrë të qëndrueshme, ku çdo qytetar gëzon një mjedis urban të sigurt, të bukur dhe funksional. Ne synojmë të jemi liderë në planifikimin urban inovativ dhe të integruar, duke përdorur teknologji të avancuar gjeodezike dhe të dhëna të sakta kadastrale për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe të balancuar të komunës. Me një përkushtim të thellë ndaj transparencës dhe përfshirjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse, ne synojmë të sigurojmë që të gjitha projektet dhe politikat tona të reflektojnë nevojat dhe aspiratat e komunitetit tonë. Duke mbrojtur dhe ruajtur trashëgiminë tonë kulturore dhe mjedisore, ne angazhohemi të krijojmë një të ardhme të ndritshme dhe të begatë për të gjithë qytetarët e Mitrovicës Veriore.

## **DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT**

**Drejtore: znj. Arta AZEMI**

### **Deklarata e misionit:**

Misioni ynë është fuqizimi i të rinjve dhe krijimi i mjedisit përkrahës për zhvillimin shoqëror dhe personal të tyre, krijimin e mundësive për promovim, zhvillim dhe pjesëmarrje të të rinjve në jetën aktive shoqërore si dhe ofrimin e shërbimeve të barabarta për të rinjtë, që mundësojnë zhvillimin e shkathtësive jetësore dhe vlerave shoqërore.

Po ashtu, ndër misionet tona është edhe hartimi i politikave mbrojtëse dhe promovuese të trashëgimisë kulturore, hartimi i planeve për mbështetje kulturore, rinore dhe sportive. Shënimi i datave historike, përkrahja e asociacioneve, klubeve dhe shoqatave në aktivitetet e tyre. Gjithashtu ne synojmë të bëjmë nxitjen e investitorëve dhe kërkimin e fondeve shtesë, bashkëpunimin me qytete tjera për të mundësuar ndarjen e përvojave, bashkëpunimi me OJQ dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

### **Deklarata e Vizionit:**

Visioni ynë është nxitja dhe ndihmimi i artistëve dhe krijuesve të rinj për të shprehur talentet e tyre nëpërmjet ekspozitave, performancave, dhe aktiviteteve krijuese. Përkrahja dhe promovimi i kulturave të ndryshme, organizmi i ngjarjeve kulturore dhe festivale që përfaqësojnë kulturat e ndryshme të komunitetit duke promovuar diversitetin kulturor. Mbrojta dhe promovimi i trashëgimisë kulturore. Investimi në ndërtimin e fushave sportive dhe objekteve tjera për të përmirësuar infrastrukturën sportive të komunitetit.

Organizimi i aktiviteteve sportive dhe programet shëndetësore që inkurajojnë komunitetin të jetë më aktiv dhe të kujdeset për shëndetin e tyre. Inkurajimi i pjesëmarrjes së komunitetit në aktivitete kulturore, sportive dhe rinore, duke organizuar takime të hapura për të dëgjuar dhe për të marrë sugjerime nga qytetarët. Ndërtimi i partneriteteve me organizatat e tjera për të arritur qëllimet e përbashkëta dhe për të shfrytëzuar burime të përbashkëta për të financuar dhe implementuar projekte.

## **DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE**

**Drejtoresh: znj. Milica FILIPOVIC**

**Drejtoresh e Q.P.S. znj. Edita BILALLI**

### **Deklarata e misionit:**

Qendra për Punë Sociale në Mitrovicën Veriore ka për qëllim t'u ofrojë të gjithëve ndihmën e nevojshme, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare dhe kombëtare. Ndihma dhe fuqizimi i familjeve të rrezikuara, në mënyrë që ato të eliminojnë rrethanat negative të jetës, të cilat pa ndihmën profesionale të punonjësve socialë, vështirë se mund t'i zgjidhin vetë.

### **Deklarata e Vizionit:**

Vizioni ynë është që komuna e Mitrovicës së Veriut të jetë një nga komunat më të zhvilluara që çdo qytetar të ketë mundësi dhe të drejta të barabarta.

Shërbimet shëndetësore të jenë cilësore, të sigurta, efikase, të bazuara në parimet e humanizmit dhe profesionalizmit, si dhe lehtësisht të qasshme për qytetarët dhe për t'i udhëzuar ata për trajtim të mëtejshëm.

## **ZYRA PËR KOMUNITETE LOKALE DHE KTHIM**

**Drejtor: z. Jeton RRAHMANI**

### **Deklarata e misionit:**

Qëllimi kryesor i Drejtorisë për Komunitete Lokale Kthim në Komunën e Mitrovicës Veriore është të kontribojë në zhvillimin e përgjithshëm të të gjitha komuniteteve të Komunës, duke mos bërë dallime në mes tyre. Drejtoria Lokale për Komunitete dhe Kthim i dedikohet shërbimit të komuniteteve jo-shumicë për realizimin e të drejtave të tyre, të parapara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjeve në fuqi. Promovimin e barazisë dhe mos diskriminimit si në nivelet lokale ashtu edhe në ato qendrore. Kjo drejtori funksionon për të zgjedhur dhe adresuar nevojat e pjesëtarëve të ktyre komuniteteve dhe strukturat institucionale përgjegjëse.

### **Deklarata e qëllimit:**

Përmban synimin për gjithëpërfshirjen dhe avancimin e të gjitha komuniteteve në shoqërinë kosovare, duke i motivuar ata të jetojnë dhe të kontribojnë në Komunën e Mitrovicës Veriore. Përfshirja e tyre në aktivitete të ndryshme kulturore, sportive, dhe sociale është një pjesë e këtij qëllimi. Përmes kësaj gjithëpërfshirjeje, Komuna e Mitrovicës Veriore synon të sigurojë një nivel të barabartë të shërbimeve për të gjitha komunitetet, pa dallim nëse janë shumicë apo joshumicë në qytet.

## **DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE MBROJTJES SË MJEDISIT DHE PYJEVE**

**Drejtores: znj. Blerta ABRASHI**

### **Deklarata e misionit:**

Misioni i Drejtorisë për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve është të promovojë dhe mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit bujqësor dhe rural, duke siguruar menaxhimin efikas dhe mbrojtjen e resurseve natyrore dhe pyjeve. Ne angazhohemi për rritjen e produktivitetit bujqësor, përmirësimin e kushteve të jetesës në zonat rurale, dhe ruajtjen e ekosistemeve natyrore në përputhje me standardet mjedisore, duke kontribuar kështu në zhvillimin ekonomik, social dhe ambiental të vendit.

### **Deklarata e qëllimit:**

Qëllimi i Drejtorisë është të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe efikas të sektorit bujqësor dhe rural, duke mbrojtur dhe menaxhuar në mënyrë të përgjegjshme burimet natyrore dhe pyjet. Ne synojmë të rrisim cilësinë e jetës së komuniteteve rurale, të promovojmë praktika bujqësore inovative dhe miqësore me mjedisin, dhe të mbrojmë biodiversitetin për të siguruar një ambient të shëndetshëm për brezat e ardhshëm.

### **Shënim:**

*Drejtoria për Buxhet dhe Financa mban të drejtën të bëjë plotësim - ndryshime në çdo kohë deri të bëhet aprovimi në Kuvend Komunal, sa i përket Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitet 2026-2028 varësisht nga udhëzimet e Qarkoreve Buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.*